



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:004595  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05635859

Kom.Dh.Shk.II.nr.46/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Shoqëria për Prodhim Tregti dhe Transport Premi Oil Doel Import, Eksport, me seli në Kumanovë, Maqedoni e Veriut, që sipas autorizimit përfaqësohet nga N.A.C. avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shehu Oil Sh.P.K. me seli në Rahovec, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.218/22, të datës 23.10.2023, me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Shoqëria për Prodhim Tregti dhe Transport Premi Oil Doel Import, Eksport, me seli në Kumanovë, Maqedoni e Veriut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.218/22, të datës 23.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykat1 Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.218/22, të datës 23.10.2023, e ka Aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit Shehu Oil Sh.P.K. me seli në Rahovec, të ushtruar kundër Urdhrit për lejin e përmbaremit P.nr.826/19, i datës 20.09.2019, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, ashtu që e ka shfuqizuar Urdhrin për lejin e përmbaremit P.nr.826/19, i datës 20.09.2019, duke i abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbaremore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e kreditorit në tersi si e bazuar dhe të aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kreditori Shoqëria për Prodhim Tregti dhe Transport Premi Oil Dooel Import, Eksport, me seli në Kumanovë, Maqedoni e Veriut, me datë 20.09.2019, ka ushtruar propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave : nr. 012/2019; 013/2019; 014/2019; 015/2019; 018/2019; 019/2019; 020/2019; 035/2019; 036/2019; 037/2019; 050/2019; 051/2019; 053/2019; 054/2019; 056/2019; 060/2019; 062/2019; 064/2019; 065/2019; 066/2019; 082/2019; 088/2019; 095/2019; 102/2019; 103/2019; 112/2019; 113/2019; 120/2019; 121/2019; 131/2019 dhe 012/2019, për shumën prej 26,700.00€.

Përmbareuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 20.09.2019, ka nxjerrë Urdhrin Përmbaremore P.nr.826/19, me të cilin ka caktuar përmbaremin sipas propozimit të kreditorit, në bazë të faturës së lartpërmendur, që konsiderohet dokument përmbaremore në bazë të nenit 29 të Ligjit të Procedurës Përmbaremore (LPP).

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar Urdhrin në fjalë si të padrejtë dhe të pabazuar, ngase nuk plotësohet kushtet e dokumentit përmbareues, pasi që mungon pranimit i faturës nga ana e debitori, pra është faturë e njëanshme dhe e pa përshtatshme për përmbaremore, andaj propozojmë që të aprovohet prapësimi dhe urdhëri përmbaremore të shfuqizohet dhe të obligohet të gjitha shpenzimet e procedurës ti bartë kreditori.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar pretendime e debitorit në prapësim dhe ka propozuar që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar dhe urdhëri përmbaremore të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori ti bartë shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.218/22, të datës 23.10.2023 e ka Aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit Shehu Oil Sh.P.K. me seli në Rahovec, të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit P.nr.826/19, i datës 20.09.2019, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, ashtu që e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbaremit P.nr.826/19, i datës 20.09.2019, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse

faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim. Gjukata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbarues ka caktuar përmbarimin, nuk i plotëson tiparet e përmbarueshmërisë.

Me Nenin 38 par. 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) është paraparë që *”Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturave të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase mungon pranimi i rregullt vula dhe nënshkruar nga pala debitorë

Gjukata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në bazë të nenin 38 të LPP-së, ngase me propozim për përmbarim kreditori nuk e ka specifikuar faturat me numër dhe me datë ndaj të cilave inicohet procedura përmbarimore, ndërsa në propozimin për përmbarim ka përshtuar vetëm, faturat relevante, faturat e bashkangjitur. Po ashtu në propozimin për përmbarim ka listuar si provë pasqyrën e faturave të papaguara në valutën euro për periudhën 04.01.2019 e deri më datën 29.03.2019 në vlerën prej 26,700.00€, mirëpo pa e specifikuar secilën faturë në propozim për të vlerësuar si dokument i besueshëm dhe për të e plotësuar kushtin ligjore në kuptim të nenit 37 par.1 të LPP-së, e cila dispozitën qartazi përcakton se propozimi për përmbarim duhet të tregojë dokumentin përmbarimor apo dokumentin e besueshëm në bazë të të cilit duhet të kërkohet përmbarimi.

Së këndejmi, Gjukata gjen se urdhri për përmbarim i caktuar nga përmbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 38 të LPP-së.

Gjithashtu sipas nenit 43 par.4 të LPP-së përcaktohet se : *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*. Prandaj në këtë rast, gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit duke e shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.826/19 i lejuar me datën 20.09.2019.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.46/24, me datë 29.04.2024

Gjyqtari  
Dren Rogova